

# COVID-19 PËRMBLEDHJE E UDHËZIMEVE #5

## Farmacitë e rrjetit të hapur dhe planet e emergjencave

Masat e mëposhtme duhet të merren parasysh nga administratori/ët i/ e farmacisë

1. Zhvilloni plane emergjente në rastet me fluks pune
2. Kryeni trajnime të plota për personelin
3. Përqendrohuni në gjendjen shëndetësore të farmacistëve
4. Mbroni personelin e farmacisë
5. Forconi monitorimin e infeksionit nga farmacistët
6. Siguroni një menaxhim përshtatshëm të pastrimit dhe dezinfektimit
7. Forconi menaxhimin e pacientit
8. Forconi informimin e pacientëve
9. Forconi menaxhimin e ekspozimit ndaj infeksionit
10. Forconi menaxhimin e mbetjeve mjekësore

Rekomandohet që i gjithë ekipi i farmacive të trajnohet në:

- Informacion teknik dhe shkencor për COVID-19, veçanërisht për simptomat, periudhën e inkubacionit dhe mënyrat e transmetimit të virusit;
- Informacion epidemiologjik për zonat e prekura. Për shifrat e përditësuara të numrit të rasteve të konfirmuara për çdo vend;
- Informacion mbi masat parandaluese përfshirë informacionin për dezinfektuesit dhe procedurën e higjienizimit të duarve;
- Si të procedohet për një rast të dyshuar, përfshirë strategjitë që duhet të zbatohen secila farmaci;
- Materialet në dispozicion për të mbështetur ndërhyrjen (fletushkat e informacionit, tabelat e përhapjes së virusit, dhe faqet e internetit të sakta të informacionit).

*Ky dokument është përkthyer nga anglishtja nga Orion JUCJA, Urdhri i Farmacistëve të Shqipërisë. Në rast të ndonjë divergjence midis dy teksteve, dokumenti origjinal i Federatës Ndërkombëtare Farmaceutike në anglisht prevalon. E drejta e autorit mbetet ajo e Federatës Ndërkombëtare Farmaceutike.*

Për detaje dhe referenca mbështetëse, konsultohuni me dokumentin e plotë udhëzues në [www.fip.org/coronavirus](http://www.fip.org/coronavirus)

Ky dokument bazohet në provat dhe rekomandimet në dispozicion të organizatave me reputacion në kohën e publikimit. Ai do të përditësohet kur njohuritë e reja bëhen të disponueshme. 26 Mars 2020.

